



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.09.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1.Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës "Për kthimin e ligjit nr. 38/2019 "Për disa shtesa ndryshime në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"".

2. Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës "Për kthimin e ligjit nr. 44/2019 "Për disa shtesa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar".

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Alket Hyseni, Elena Xhina, Spartak Braho, Alban Zeneli, Andi Permeti, Aurora Mara, Elda Hoti, Adriatik Alimadhi dhe Xhemal Qefalia

Mungojnë:

Edmond Leka, Jurgis Çyrbja, Damian Gjiknuri, Ediola Braha dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Bledar Dervishaj – Këshilltar Ligjor i Presidentit

Krisilda Fana- Drejtore e Drejtorisë Juridike

Pandeli Majko- Ministër i Diasporës

Etilda Gjonaj - Ministre e Drejtësisë

Besmir Beja - Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e komisionit për ditën e sotme. Kuorumi është i pranishëm për të vazhduar me dy çështje që kemi sot në rendin e ditës: shqyrtimin e dekretit të Presidentit të Republikës "Për kthimin e ligjit nr. 38/2019 "Për disa shtesa ndryshime në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"". Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relator do të jetë kolegu Bashkim Fino.

Kemi prezent në shqyrtimin e këtij dekreti: zotin Pandeli Majko, ministër i Diasporës. Zoti Majko mirë se keni ardhur në Komisionin e Ligjeve!

Nga Presidenca kemi: zotin Bledar Dervishaj, këshilltar ligjor i Presidentit dhe zonjën Krisilda Fana, drejtore e Drejtorisë Juridike. Mirë se keni ardhur në komision!

Fjalën e ka zoti Dervishaj për të prezantuar përpara kolegëve të komisionit arsyet pse Presidenti i Republikës e ka kthyer ligjin nr. 38 të vitit 2019 "Për disa shtesa ndryshime në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"". Më pas do t'ua kaloj fjalën kolegut zotit Fino. Si dhe përfaqësuesve të Presidencës dhe të Ministrisë së Diasporës. Pastaj do të kemi pyetje dhe përgjigje.

Bledar Dervishaj - Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kuvendi i Shqipërisë në seancën plenare të datës 20 qershor ka miratuar ndër të tjera edhe ligjin nr. 38/2019 "Për disa shtesa ndryshime në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"". Ky ligj i është përcjellë Presidentit të Republikës për dekretim dhe shpallje. Në thelb të tij dhe në përmbajtje janë 4 nene ku synohen dy ndryshime kryesore, dy shtylla ndryshimesh. Nga shqyrtimi i praktikës parlamentare rezulton se ligji në Kuvend ka synim parësor të tij implementimin sa më të plotë të dispozitave kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që jetojnë jashtë kufijve të vendit tonë, si dhe krijimin e mekanizmave ligjorë në nivel vendor për sa i përket zhvillimit të këtyre raporteve me diasporën. Realizimi i këtij qëllimi bëhet i mundur nëpërmjet nenit 1 kryesisht, por edhe nenit 2 të ligjit që është objekt shqyrtimi.

Një tjetër ndryshim i propozuar në këtë ligj gjatë praktikës së shqyrtimit parlamentar në Komisionin e Ligjeve ka të bëjë edhe me ndarjen e kompetencave të këshillit bashkiak në rastet e tjetërsimit të pronës për të drejtën e dhënies në përdorim apo për tjetërsimin e saj. Me këto ndryshime është konstatuar se është zgjeruar koncepti i tjetërsimit të pronës publike, duke shtuar brenda saj dhe të drejtën e zhvillimit të pronës në organet e pushtetit vendor. Konkretisht nëpërmjet ligjit nr. 38 synohet të ndryshohen nenet 54 dhe 55 të ligjit nr. 139 që parashikojnë detyrat dhe kompetencat e këshillave bashkiake, mënyrën e vendimmarrjes, kuorumin e vendimmarrjes dhe për çdo vendimarrje të këtyre organeve, duke përfshirë dhe vendimmarrjen që rregullon tjetërsimin e pronës publike. Ky projektligj rezulton se është shqyrtuar në dy komisione: në Komisionin e Jashtëm, për sa i përket shtyllës së parë të ndryshimit, si edhe në Komisionin e Ligjeve që është komisioni përgjegjës. Presidenti e shqyrtoi ligjin duke iu referuar përmbajtjes së aktit dhe praktikës parlamentare, si dhe legjislacionit ekzistues në fuqi. Presidenti ka bërë një vlerësim të kujdesshëm të përmbajtjes së aktit të miratuar në raport edhe me interesin publik.

Në përfundim të këtij shqyrtimi Presidenti vlerëson dhe ka vlerësuar të evidentojë se dispozitat e nenit 1 janë një hap shumë pozitiv i Kuvendit të Shqipërisë në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të shqiptarëve që jetojnë jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë. Kjo është cituar edhe në arsyetimin tonë bashkëlidhur dekretit. Nëpërmjet dispozitave të nenit 1 shtetit shqiptar bën një hap të rëndësishëm drejt procesit të implementimit të reformës ligjore dhe institucionale për ndërtimin e marrëdhënieve të natyrshme të atdheut me shtetasit e tij. Nisur nga këto qëllime shumë pozitive Presidenti shpreh dakordësinë për realizimin e këtyre shtesave sipas nenit 1 të bëra në ligjin objekt shqyrtimi.

Por nga ana tjetër, thelbi për të cilin është kthyer ky ligj për rishqyrtim referuar përmbajtjes së neneve 3 dhe 4 të ligjit nr. 38/2010 që është objekt i këtij shqyrtimi Presidenti ka arritur në përfundimin se gjatë shqyrtimit parlamentar nga relatori i projektligjit janë propozuar disa ndryshime, të cilat janë pranuar edhe nga komisionet, më pas edhe nga seanca plenare, që u kthyen në ligj, të cilat cenojnë procesin vendimmarrës të këshillave bashkiake në lidhje me tjetërsimin e pronave publike.

Këto ndryshime janë të pajustificuara pasi mënyra e re që propozohet për kuorumin e nevojshëm në këshillat bashkiake dhe vendimmarrjes së tyre nuk garanton mbrojtjen e interesit publik në procedurat e tjetërsimit të pronës publike që janë në pronësi të pushtetit vendor. Nëpërmjet këtyre ndryshimeve në nenet 3 dhe 4 të ligjit nr.38 ulet niveli i kontrollit të organit kolegjal, të këshillit bashkiak ndaj propozimeve të organit ekzekutiv,

kryetarit të bashkisë, çka krijon mundësi që zhvillimi i pronave të shtetit në bashkëpunim me personat e tretë të realizohet përkundrejt përfitimeve jo të qarta për interesin publik dhe jo në përputhje me kërkesat apo kushtet që ofron tregu. Këshilli bashkiak për të gjitha vendimet ku do të trajtohen vendimmarrjet e tjetërsimit apo të dhënies së pronave në përdorim në favor të subjektit të tretë sipas legjislacioni ekzistues apo atyre neneve që synohen të ndryshohen legjislacioni, parashikon një kuorum prej 3/5-ve të vendimmarrjes së anëtarëve të Këshillit Bashkiak.

Ulja e këtij kuorumi në shumicë të thjeshtë, 50+1, hap mundësinë për cenim të interesit publik.

Presidenti ka vlerësuar se Kuvendi i Shqipërisë me ndryshimet në këto dy nene, nenin 3 dhe 4, po krijon një kompetencë të re të autoriteteve vendore që është në thelb futja e organit të autoritetit vendor si zhvillues i pronave apo në partneritet me subjektin privat për të tjetërsuar pronat e tyre. Prandaj, ndryshimet e bëra për të ulur, qoftë edhe kuorumin vendimmarrës, qoftë edhe futjen e kësaj kompetence të re pa sqaruar mënyrën se si do të shkohet te ky vullnet vendimmarrës, krijon hapësirë për cenim të interesit publik.

Për të mos u zgjatur më shumë këto janë arsyt kryesor. Presidenti me dekretin e tij, objekt shqyrtimi në këtë komision, ka vendosur kthimin për rishqyrtim vetëm të dy neneve të këtij ligji, nenit 3 dhe nenit 4.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Dervishaj!

Urdhëroni, zoti Majko!

Pandeli Majko – Nuk kam ndonjë koment specifik, pasi, siç u shpreh edhe përfaqësuesi i presidencës, propozimet që ne kemi bërë për hapjen e zyrave të diasporës në të gjitha bashkitë e Shqipërisë, Presidenti i vlerëson si të dobishme, por, gjithsesi, mendoj që me një konsultë paraprake e presidencës me parlamentin, por kjo është jashtë kontekstit, mund të ndodhë në mënyrë të natyrshme pasi nuk shoh ndonjë problem që ka të bëjë prekjen e diskrecionit që ka parlamenti si të drejtë për të vendosur mbi shumicat vendimmarrëse, qoftë në bashki, qoftë në vendimmarrje të natyrave të tjera. Në fund fare, çdo shumicë mbetet shumicë. Shumicat e cilësuara janë gjithmonë prerogativë e parlamentit dhe vetëm e tij.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër, që jeni këtu!

Faleminderit, zoti Dervishaj që ma rikujtuat, pasi e kisha lexuar me shumë kujdes relacionin, të cilin ka kthyer Presidenti i Republikës për ligjin nr.38/2019!

S'do të ishte keq sikur këtu të ishte edhe këshilltari për pushtetin vendor i Presidentit, por kjo është çështja juaj. Ajo për të cilën më vjen më shumë keq është fakti se në relacionin që kam lexuar, vërej me keqardhje (personale e kam këtë vërejtje, nuk e kam politike apo juridike), se gjithë relacioni është drejtuar kundër relatorit.

Me lejoni t'ju lexoj, në faqen e parë të relacionit të Presidentit, thuhet se nga shqyrtimi i praktikës parlamentare rezulton se ndryshimet e propozuara në nenet 54 dhe 55 të ligjit nr.139/2015 nuk janë propozuar nga KM-ja, por ato janë propozuar dhe paraqitur nga relatori i projektligjit.

Në faqen e dytë të relacionit të Presidentit, thuhet se, nga ana tjetër, referuar përmbajtjes së nenit 3 dhe 4 të ligjit 38/2019, objekti i shqyrtimit të Presidentit të Republikës ka arritur në përfundimin se propozimi i relatorit për realizimin... e të tjera e të tjera.

Në faqen tjetër thuhet se komisioni ka marrë në shqyrtim dhe ka pranuar propozimin e paraqitur nga relatori... e të tjera e të tjera.

Me sa duket, Presidenti e paska personale ose ju si këshilltarë e keni personale me mua, a thua se unë jam një relator antikushtetues.

Më lejoni t'u drejtohem medieve se Presidenti im i nderuar, për të cilin unë kam shumë respekt, para se të bëhej President ka qenë 4 vjet Kryetar Kuvendi dhe i di fare mirë procedurat se si veprohet kur një projektligj vjen nga qeveria apo një grup deputetësh në Parlamentin shqiptar. Në çdo komision përkatës ka një relator që përgjigjet për projektligjin për në rastin konkret dhe që e paraqet para kolegëve të çdo komisioni. Është komisioni dhe relatori ai që bëjnë ndryshimet e nevojshme ose nuk bëjnë ndryshime fare dhe pastaj në fund definon seanca plenare, duke e votuar atë.

Këtë praktikë ka ndjekur zoti Ilir Meta kur ishte kryetar Kuvendi, këtë praktikë po ndjekim edhe ne, duke vazhduar edhe sot, që do të thotë se unë jam një relator kushtetues, i rregullt, i drejtë dhe, mbi të gjitha, zoti President, më lejoni t'ju them se ligji nr.139 apo ligji i datës 31.7.2000 është ligji bazë i organeve të vetëqeverisjes vendore, të cilin kam pasur fatin dhe nderin ta drejtoj bashkë me kolegët deputetë apo edhe me shoqatat e kryetarëve të bashkive, ligj i cili ka ndryshuar shumë pak në këto vite. Ka ndryshuar shumë pak në vitin 2004 për t'u dhënë kompetenca kryetarëve të fshatit dhe është ndryshuar dhe është bërë një ligj i ri në vitin 2015 si rezultat i ndarjes territorial-administrative që është bërë në Shqipëri,

edhe me ndihmën e kryetarit të Kuvendit të asaj kohe dhe në funksion të saj kemi bërë edhe ligjin e ri të vetëqeverisjes vendore.

Më lejoni të hyj vetëm në argumente pa e zgjatur dhe pa i mërzhitur kolegët.

Absolutisht jam dakord me Presidentin për dy nenet e para për ngritjen e zyrave të diasporës, sepse kjo ka qenë edhe arsyeja për të cilën ligjin ka ardhur këtu, por të mos harrojmë se një ligj që është me 3/5-at në parlament, siç është ligji nr.139, është një ligj që (se unë drejtoj nënkomisionin e pushteti vendor) ka pasur kërkesa nga shoqatat e bashkive për ndryshime të neneve të caktuara të ligjit dhe natyrisht ne nuk mund ta ngacmojmë ligjin sa herë që ka kërkesa. Në momentin që iniciatore bëhet qeveria dhe ngritja e zyrave të diasporës ishte shumë e rëndësishme ne pamë të arsyeshme të bënim tre ndryshime teknike:

Së pari, ngritjen e zyrave të diasporës.

Së dyti, ndryshuam datën (të cilën ju nuk e përmendni fare në relacion, por po e them unë) e bilancit financiar, që do të raportonim me 31 mars, do të raportohet me 31 maj. Pra, u dakordësua me ligjin e financave lokale.

Së treti, nga kërkesat që kishte bërë prej kohësh në takimet e ndryshme që kemi bërë me shoqatat e bashkive, ishte fjala për nenin 54, germa “e”, fjala është për tjetërsimin e pronës dhe për dhënien me qira. Tjetërsimi i pronës është kur një bashki e jep një pronë të caktuar e jep dhe e shet. Natyrisht, vendimmarrja është me 3/5-t e këshillit përkatës dhe ne e kemi lënë ashtu si ç’është.

Pjesa tjetër, kur do të bësh një zhvillim ekonomik apo ta japësh me qira, nuk ka kuptim që të pezullohet apo të pengohet bashkia për të votuar me 3/5-t, sepse nuk e humbet të drejtën e pronësisë bashkia të një prone tjetër, që është pronë publike dhe pronë e saj, kur e jep me qira apo për një zhvillim ekonomik. Mund ta japë për 1, për 2 apo për 3 vjet dhe mund të mos ketë interes ta anulojë kontratën dhe t’ia japë një tjetri, pra pronësia ngelet po prapë e bashkisë, pra nuk i humbet pronësia.

Aty ku i humbet pronësia, në rastin konkret, është rasti kur shitet dhe natyrisht jepet me 3/5-t. Pjesa tjetër është një pjesë funksionale e bashkisë dhe unë nuk mendoj sipas relacionit të Presidentit, që do të ketë pretendime se mund të keqpërdoret me pasoja të pariparueshme për pronën publike, të interesit publik e të tjera e të tjera.

Më lejoni t’u drejtohem në mënyrë juridike sipas propozimit apo edhe relatimit që bëri zoti Dervishaj. Neni 9 i ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Njësitë e qeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë nëpërmjet fitimit, shitjes dhe dhënies në

përdorim të pronës së paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejtën e tyre sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Parashikimi i bërë nga ana jonë për nenin 3 të ligjit 38/2019, nëpërmjet të cilit shtohet kompetenca e njësisë së qeverisjes vendore për zhvillimin e pronës nëpërmjet bashkëpunimit me subjekte private, përmban një kompetencë të re për njësitë e qeverisjes vendore dhe kjo s'ka qenë e parashikuar në ligj.

Në dhjetëvjeçarin e fundit është konstatuar se zhvillimi infrastrukturor dhe urban i qyteteve ka kërkuar zhvillim të njëkohshëm apo të përbashkët të pronës publike apo private, por në mungesë të parashikimeve të qarta ligjore, organet e qeverisjes vendore janë stepur apo janë penguar të miratojnë akte për zhvillimin e pronës publike në pronësi të tyre.

Këto situata kanë penguar zhvillimin e projekteve të rëndësishme publike. Ligji 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, që është i lidhur me ligjin e pushtetit vendor, jep këtë përkufizim për të drejtën e zhvillimit: “E drejta për zhvillim është e drejta ligjore për të zhvilluar një parcelë ose një zonë, në përputhje me dokumentet e planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit. E drejta për zhvillim është e dallueshme nga e drejta e pronësisë.”

Po e theksoj: e drejta për zhvillim është e dallueshme nga e drejta e pronësisë. Këtë e thotë ligji i planifikimit të territorit, dhe jepet nga autoriteti vendor i planifikimit, i cili ka kompetencën për të rregulluar përdorimin e tokës në juridiksionin e tij, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.

E drejta për zhvillimin e pronës, edhe pse është pjesë e tagrave të pronësisë, është totalisht e dallueshme, kolegjë, nga e drejta e pronësisë, e lidhet me planifikimin vendor dhe përdorimin e tokës.

Tjetërsimi i pronës, qoftë ajo publike apo private, është e lidhur me transferimin e tre tagrave të pronarit: të posedimit, të gëzimit dhe atë të disponimit. Në rastin e tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme, Kodi Civil ka parashikuar edhe elementë formalë, që duhet të përmbushë veprimi juridik i tjetërsimit. Mënyra e përpunimit të aktit noterial të tjetërsuar të pasurisë së paluajtshme është parashikuar dhe shprehur edhe në ligjin specifik që kemi bërë, 110/2018 “Për noterinë”, neni 126, që thotë: “Akti noterial për tjetërsimin ose njohjen e pronësisë mbi sende të paluajtshme ose i një të drejte reale mbi to, kryhet nga noteri, pasi të ketë verifikuar pronësinë e palëve mbi sendin e paluajtshëm. Për kryerjen e këtij verifikimi, pala i paraqet noterit dokumentin e nevojshëm të pronësisë, si dhe autorizimin e saj me shkrim.”

Pra, çfarë dua të them? Dua të them se pronari ose bashkia, në rastin konkret, me ushtrimin e së drejtës për zhvillim nuk tjetëron pronën, absolutisht që nuk e tjetëron pronën, por në marrëveshje me pronarë të tjerë, me biznesmenë të tjerë, me subjekte të tjerë privatë, bie dakord për zhvillimin e projekteve të përbashkëta, duke rritur përfitimet e saj ose edhe të atij që e ka marrë në ushtrimin e të drejtës së pronësisë mbi një pronë të caktuar.

Në rastin e zhvillimit të një pasurie të paluajtshme, është plotësisht e qartë se nuk kemi të bëjmë me tjetërsim, pasi në këtë rast njësia e vetëqeverisjes vendore nuk i kalon zhvilluesit privat tagrin e disponimit, që është edhe një prej tagreve më të rëndësishëm të pronarit. Përkundrazi, ia jep në përdorim, e zhvillon, ia jep me qira, por ajo prapë ngelet pronë e bashkisë.

Në referim të argumenteve të dhëna nga Presidenti i Republikës, është e paqartë se përse vendimmarrja me shumicë të cilësuar, e këtë po e shtroj si pyetje, në rastin e ushtrimit të kompetencave për dhënie në përdorim ose për zhvillim të pronës, konsiderohet me interes publik, dhe në rastin kur kjo vendimmarrje merret po nga i njëjti organ, por me shumicë të thjeshtë, pretendohet se mund të keqpërdoret me pasoja të pariparueshme për pronën publike dhe interesin publik. Kjo sepse në thelb kemi të bëjmë me një kompetencë, vendimmarrja për realizimin e të cilit merret nga organi përfaqësues i njësisë vendore.

Ndryshimi i vetëm i miratuar nëpërmjet nenit 4 të ligjit 38/2019, ka synuar të bëjë një ndarje ndërmjet kuorumit të nevojshëm të vendimmarrjes, në rastin e tjetërsimit të pronës, të njësisë së qeverisjes vendore, i cili vazhdon të mbetet me shumicë të cilësuar të anëtarëve të këshillit bashkiak, pra siç e kemi lënë, nga rasti i dhënies në përdorim dhe dhënies për zhvillim të pronës të tretëve, ku kuorumi i këshillit të bashkisë parashikohet të jetë men shumicën e votave të të gjithë anëtarëve. Kjo për arsye se tjetërsimi hyn te tagrat e jashtëzakonshëm, ndërsa dhënia në përdorim është tagër i zakonshëm, nëpërmjet të cilit pronari nuk transferon tagrin më të rëndësishëm, atë të disponimit.

Nëse tjetërsimi ndodh vetëm një herë, duke kaluar nga pronari bashki tek individ, dhe dihet se kur shitet s'është më e saja, sa i takon dhënies në përdorim dhe veprimtarisë që mund të ketë, i njëjti pronar që mund ta japë disa herë. Pra, unë mund ta jap me qira, mund ta jap për zhvillim, si bashki, një truall të caktuar, një pronë, por ajo prapë mbetet prona ime. Nesër mund t'ia jap një njeriu tjetër. Pra, nuk i kam dhënë të drejtën që ta blejë. Prandaj, edhe ne kemi bërë ndarjen: me tre të pestat dhe me votim të thjeshtë.

Madje kemi bërë një gabim, dhe e them këtë meqenëse jam njohës i çështjes dhe e kam bërë vetë ligjin e pushtetit vendor. Po pse e kemi bërë gabim? Ja, t'ju jap një shembull,

zoti Dervishaj, një shembull që lidhet me jurisprudencën, që ju duhej ta kishit kapur më përpara. Për më tepër, po bëj një paralelizëm në lidhje me procedurën e dhënies së zhvillimit e të përdorimit, pra të qirave, të pasurive të paluajtshme në pronësi ose në përgjegjësi të administrimit të institucioneve të pushtetit qendror. Ne kemi vendimmarrje nga një ministër, e me urdhër madje, as me vendim qeverie jo, kur jepet me qira toka. Pra, një individ, një ministër e jep në mënyrë monokratike, ndërkohë që çfarë po bëjmë këtu? Këtu themi: jo, edhe kur duam ta japim me qira apo ta zhvillojmë, duhet ta votojë shumica e anëtarëve të këshillit bashkiak.

Madje, meqenëse ju e keni kthyer, dhe keni bërë mirë që e keni kthyer, unë kam të drejtë të propozoj që ta ketë kompetencë kryetari i bashkisë, siç e ka ministri. Njësoj është. Pra, pronë është ajo që ministri, me një firmë që hedh e jep me qira, pronë është edhe kjo e pushtetit vendor, që një kryetar bashkie mund të hedhë firmën e ta japë me qira, por gjithnjë duke ngelur pronë e bashkisë. Tjetërsimi, sipas ligjit që kemi, bëhet me tri të pestat. Ky është një rast specifik. Atëherë, ndryshe e bëjmë me qeverinë, ndryshe e bëjmë me bashkinë.

Megjithatë, ne prapë themi: të bëhet me vendim të këshillit bashkiak, por me shumicën e anëtarëve. Këta thonë të presidencës. Jo, me tri të pestat edhe dhënia me qira, edhe zhvillimi. Është absurde po të bësh këto krahasime.

Sa i takon shqetësimit të ngritur në dekretin e Presidentit të Republikës, se ligji nuk ka parashikuar mënyrën se si këto autoritete, dhe në fakt kjo është për të qeshur, do të formojnë vullnetin e tyre për të zgjedhur subjektin me të cilin do të hyjnë në marrëdhënie për të zhvilluar pasuritë e paluajtshme, paqartësi e cila krijon shteg për abuzime, thotë Presidenti, e për keqpërdorim të kompetencave me pasoja të pariparueshme për pronën publike dhe interesin publik, ne vlerësojmë e theksojmë se: kompetencat dhe mënyrat e ushtrimit të tyre rregullohen nga një kuadër i tërë ligjor, i cili normon veprimtarinë e organeve publike nëpërmjet parimit dhe rregullave të ushtrimit të kësaj veprimtarie. Njësitë e qeverisjes vendore janë së pari organe publike, të cilat në ushtrimin e funksionit të tyre u nënshtrohen dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative. Është ligji 44/2015.

Në disa dispozita të tij, ky ligj ka parashikuar parimet mbi të cilat mbështetet veprimtaria organike e organeve publike, mes të cilave mund të përmendim parimin e ligjshmërisë, parimin e transparencës, parimin e përgjegjësisë, parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit e të tjera.

Këto parime janë të detajuara jo vetëm në Kodin e Procedurës Administrative, por janë të zbërthyera edhe në dispozitat e ligjeve të veçanta, të cilat parashikojnë veprimtarinë e organeve publike lidhur me fushat dhe çështjet specifike.

Për më tepër, dispozitat e kundërshtuara në dekretin e Presidentit të Republikës, nuk duhet të lexohen veçmas, por në tërësinë e parashikimeve të bëra për ligjin e qeverisjes vendore. Më lejoni t’ju flas në lidhje me nenin 54, prej së cilit ju keni lexuar vetëm germën “e”; germa “g” e ligjit 139/2015 ka parashikuar se “Këshilli bashkiak miraton normat, standardet dhe kriteret për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që janë dhënë me ligj, si dhe për përmbajtjen e garantimit të interesit publik.”.

Më lejoni t’ju them se ky parashikim mbështetet plotësisht në parimet e decentralizimit e të autonomisë vendore, të sanksionuara në kartën europiane të autonomisë vendore. Sipas kuptimit të dhënë nga ky akt ndërkombëtar, i ratifikuar nga vendi ynë, e për fat të mirë e kam firmosur vetë në ligjin 8548, në vitin 1999, autonomia vendore konsiderohet e drejtë, si dhe aftësia efektive e bashkësisë vendore për të rregulluar e për të drejtuar brenda ligjit, nën përgjegjësinë e tyre e për të mirën e popullsisë së tyre një pjesë të mirë të çështjeve publike.

Pra, si rrjedhojë, më lejoni t’ju them se njësitë e qeverisjes vendore janë plotësisht kompetente në përcaktimin e kushteve, të procedurave të përfshirjes së marrëdhënieve të zhvillimit të territorit me subjekte private, në mbështetje të parimit të autonomisë vendore e të parimeve që udhëheqin vendimmarrjen e një organi publik.

Në përfundim, me keqardhje them se ne duhet ta rrëzojmë dekretin e Presidentit në lidhje me nenet 3 dhe 4, pasi për nenin 1 dhe 2 Presidenti është dakord. Jo për mua si relator dhe si njohës i mirë, së paku i ligjit të pushtetit vendor, po për argumentet që sapo dhashë më sipër, të cilat janë të pakontestueshme, për t’u dhënë mundësi organeve të pushtetit vendor që të jenë më disponibël për të dhënë me qira e për të zhvilluar pronën e tyre, gjë që është e drejtë e tyre ta bëjnë, dhe jo për ta cunguar e për të thënë se duhet bërë me tre të pestat.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

A ka pyetje nga kolegët?

Nuk ka.

A ka diskutime?

Po, zoti Dervishaj.

Bledar Dervishaj – Nuk e kam për të debatuar me të nderuarin, relatorin e këtij projektligji, por meqë u përmendëm për shqyrtime personale, më duhet t’ju saktësoj pozicionin e Presidentit të Republikës, qoftë të Presidentit në vlerësimin e këtij ligji, qoftë edhe vlerësimin tim personal, meqë u citova. Vlerësimi i ligjit bëhet vetëm dhe duke u bazuar në atë që ligji flet vetë, aktin e miratuar dhe të procedurës parlamentare. Në qoftë se është cituar relatori në relacionin e Presidentit të Republikës dhe arsytet e dekretit, kjo ka bërë me faktin e konstatimit, të gjetjeve dhe të procedurës që ka ndjekur formimi i gjithë përmbajtjes së ligjit, duke evidentuar që propozimi i qeverisë nuk përmbante ato shqetësime që janë bërë evidente në komision. Në këtë proces nuk ka asgjë personale.

Sa i takon arsyetimit tonë lidhur me përmbajtjen e neneve 3 dhe 4, jua kemi sqaruar saktësisht që në konceptin tonë zhvillimi i pronës dhe bashkëpunimi me një subjekt privat sjell tjetërsimin e saj në të tria tagrat, sepse humbet dhe zhvillohet një produkt i ri, një objekt me të drejta pronësore të reja, me përqindje të reja të pronësisë, me kushte të reja, kështu që zhvillimi i pronës dhe dhënia e saj nga autoriteti publik te privati për zhvillim është tjetërsim i plotë. Sa i takon shqetësimit për procedurën që kemi diktuar, e cila nuk parashikon norma të sakta për të diktuar vullnetin e organit të këshillit bashkiak ka të bërë me faktin që në zhvillimin e pronës ashtu siç një privat futet në investim apo në bashkëpunim me një subjekt ndërtimor, tregu ofron shumë përqindje të caktuara në zona të caktuara dhe kufijtë se ku do të ecte këshilli bashkiak, sepse këtu është shtegu që themi ne që lë... Norma duhet të ishte më e qartë.

Pa u zgjatur më shumë dua t’ju them se ne u qëndrojmë arsyetimeve të dekretit dhe kërkojmë miratimin e tij nga ky komision dhe më pas në seancë plenare.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Dervishaj!

Zoti Fino, si relator një konsideratë të fundit. Më pas do të kalojmë në votim.

Bashkim Fino – Nuk do të flas për çështjen e dytë, por për të parën.

Zoti Dervishaj, ju falënderoj, sepse nuk më kishte zënë gjumi, pasi kisha kaq ditë që lexoja dhe thosha me vete: “Ore çfarë ka Presidenti dhe këshilltarët e tij me mua si relator?” Më lejoni t’ju them se është rasti i parë që në një kthim të dekretit nga Presidenti cilësohet relatori. Janë shumë ligje të tjera që ka kthyer Presidenti i Republikës, i cili ka bërë argumentimin e tij ligjor, i drejtë apo jo i drejtë, kjo është e drejta e tij, duke thënë që Kuvendi ka vepruar gabim, të nderuar deputetë, kështu që shihni 1, 2, 3, 4 gjëra dhe t’i rregulloni. Në rastin konkret, të cilin sapo jua lexova, në tri faqe relacion përmendet vetëm

relatori, prandaj më qetësove me argumentin e dytë kur the që nuk keni asnjë gjë personale dhe nuk ka asnjë gjë për t'u shqetësuar.

Ju falënderoj shumë!

Ulsi Manja – Zoti Dervishaj, të lutem!

(Diskutime pa mikrofon)

Atëherë, meqë nga ana e kolegëve nuk pati pyetje dhe diskutime, para se ta hedh në votim dekretin e Presidentit nr. 11227, datë 15.05.2019, bashkohem me relatorin Bashkim Fino, pasi ndryshimet që iu bënë këtij projektligji, në vlerësimin tim, shkojnë në forcim të decentralizimit dhe të autonomisë vendore. E para.

E dyta, nuk është argument juridik fakti që prona publike mbrohet më mirë me 3/5-at dhe mbrohet më pak kur kjo pronë vendoset të zhvillohet me një shumicë të thjeshtë të këshillit bashkiak, siç e tha kolegu Fino. Lidhur me shqetësimin e Presidentit, edhe nëse hipotetikisht do ta pranonte këtë ndryshim ligjor që Presidenti ka lidhur me formimin e vullnetit se si do të formohet vullneti në këshillin bashkiak, më lejoni t'ju them që ligji ia ka dhënë këtë kompetencë kryetarit të bashkisë. Në të thuhet: “Me propozim të kryetarit të bashkisë”, sepse është kryetari i bashkisë ai që është mandatuar nga qytetarët për të drejtuar qytetin, ai e ka vullnetin e zgjedhësve që për ato 4 vjet që është mandatuar nga qytetarët të vendosë në përputhje me atë program që u ka prezantuar qytetarëve të vendosë edhe për zhvillimin e qytetit, ku pa diskutim përfshihet edhe prona publike.

Për të gjitha këto arsye që dha relatori, kolegu im Bashkim Fino, mua nuk më ngelet gjë tjetër veçse ta hedh në votim në komision dekretin e Presidentit të Republikës dhe më pas të procedojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Kush është dakord për rrëzimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11227, datë 15.05.2019? Kundër? 3 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Rrëzohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 11227, datë 15.05.2019 “Për kthimin e ligjit nr. 38/2019 “Për disa shtesa ndryshime në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore””.

Zoti Majko, shumë faleminderit për prezencën tuaj në komision dhe ditë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.09.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës “Për kthimin e ligjit nr. 44/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar””.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Alket Hyseni, Elena Xhina, Spartak Braho, Alban Zeneli, Andi Permeti, Aurora Mara, Elda Hoti, Adriatik Alimadhi dhe Xhemal Qefalia

Mungojnë:

Edmond Leka, Jurgis Çyrbja, Damian Gjiknuri, Ediola Braha dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Bledar Dervishaj - Këshilltar Ligjor i Presidentit

Krisilda Fana - Drejtore e Drejtorisë Juridike në Presidentë

Etilda Gjonaj - Ministre e Drejtësisë

Besmir Beja - Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Ulsi Manja - Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës. Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës “Për kthimin e ligjit nr. 44/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar””. Edhe në shqyrtimin e këtij dekreti komisioni ynë është komision përgjegjës dhe relatore është kolegja Elena Xhina. Nga institucioni i Presidencës janë prezentë zoti Dervishaj dhe zonja Fana, ndërsa nga Ministria e Drejtësisë kanë konfirmuar pjesëmarrjen ministrja e Drejtësisë, zonja Etilda Gjonaj dhe zoti Besmir Beja, drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit.

Zonja Ministre, mirë se keni ardhur në Komisionin e Ligjeve!

Zoti Dervishaj, është e njëjta procedurë që u ndoq me dekretin që sapo kaluam. Fjala është fillimisht për ju, për të na prezantuar për kolegët e komisionit, por dhe për opinionin publik arsyet pse Presidenti ka vendosur kthimin e ligjit nr. 44/2019 për rishqyrtim në Kuvend.

Më pas do t’ua kaloj fjalën ministres së Drejtësisë dhe relatores.

Fjala për ju.

Bledar Dervishaj – Faleminderit!

Kuvendi i Shqipërisë në seancën plenare të datës 18 korrik 2019 ka miratuar ligjin nr. 44/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”.

Sipas praktikës parlamentare, rezulton se këto ndryshime në Kodin Penal janë depozituar në datën 02.05.2019 si nismë e 11 deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, por këto ndryshime kanë shqyrtuar në thelb në mënyrë të përbashkët dy nisma ligjore të propozuara. Nisma e parë është depozituar në Kuvend gjatë vitit 2018 si propozim i 37 mijë e 527 shtetasve shqiptarë dhe nisma e dytë është propozuar nga një grup deputetësh. Kjo nismë parashikonte adresimin e disa çështjeve në fusha si: mbrojtja nga dhuna e profesionistit shëndetësor; mbrojtja nga dhuna e policit; funksionarit publik dhe në fusha të tjera.

Presidenti vlerësoi përputhshmërinë e ligjit nr. 44//2019 në raport me Kushtetutën dhe me kuadrin ligjor në fuqi. Në përfundim të shqyrtimit, Presidenti çmon se ky ligj i paraqitur për shpallje në përgjithësi është një akt ligjor me tendencë pozitive, pasi për disa çështje dispozitat aktuale të Kodit Penal nuk garantojnë parandalimin apo ndëshkimin e duhur të disa veprimeve apo mosveprimeve negative, që janë shfaqur në shoqëri, për të cilat është e nevojshme parashikimi i tyre si vepra penale, apo për disa prej tyre është vlerësuar se nevojitet forcimi i ndëshkimit penal. Përpos këtyre ndryshimeve, gjatë shqyrtimit u konstatua se disa dispozita të veçanta të ligjit nr. 44/2019, konkretisht nenet 3, 6, 7 dhe 11, që kanë

ndryshuar, apo janë shtuar nenet 121, 201, 201/b, si dhe 207/a të Kodit Penal, paraqesin paqartësi në formulimin e disa paragrafëve të tyre, nuk janë në harmoni apo në ndonjë rast mbivendosen me parashikime të tjera të Kodit Penal, shkaqe këto, të cilat mund të sjellin zbatim të gabuar në praktikë apo keqinterpretim me pasojë cenimin e parimeve kushtetuese të sigurisë juridike.

Nga shqyrtimi i ligjit konstatohet se formulimet e disa dispozitave të neneve të mësipërme përmbajnë problematika, që cenojnë parimin e efektivitetit të normës, duke rrezikuar aplikimin dhe interpretimin në praktikë të tyre, për shkak të mungesës së qartësisë, çka do të kërkonte shumë shpejt ose amendim të tyre, ose do të bënte të nevojshme sqarimin e tyre nga jurisprudenca, pra nga Gjykata e Lartë.

Duke pasur parasysh se Gjykata e Lartë, e cila është e ngarkuar për unifikimin apo edhe interpretimin e përdorimit të normave ligjore, prej disa muajsh nuk është funksionale dhe askush nuk mundet të parashikojë sot se kur do të plotësohet kjo trupë gjyqësore me numrin e nevojshëm të gjyqtarëve, që mund të bëjnë unifikimin e praktikës gjyqësore në procesin penal, vlerësohet se nuk do të jetë e mundur kryerja e analizës gjithëpërfshirëse të ndryshimeve dhe efekteve që mund të kenë ndryshimet e propozuara për efektivitetin e sistemit të drejtësisë penale.

Presidenti ka vlerësuar se në këto kushte ku ndodhet vendi, pa Gjykatë të Lartë dhe Gjykatë Kushtetuese funksionale i takon Kuvendit të Shqipërisë që të tregojë kujdesin maksimal gjatë hartimit dhe miratimit të dispozitave të reja në Kodin Penal, të cilat krijojnë figura të reja të veprave penale, pasi kriminalizimi i sjelljeve apo veprimeve në figura krimi, ndërkohë që ende nuk është funksionale trupa gjyqësore, e cila mund të bëjë unifikimin e praktikës gjyqësore në këtë drejtim, mund të sjellë si rezultat aplikim të ndryshëm të normës nga gjykata të ndryshme apo nga organe të ndryshme ligjzbatuese.

Konkretisht, janë vërejtur problematika në nenin 3 të ligjit nr.44/2019, i cili synon ndryshimin e nenit 121 të Kodit Penal, që parashikon veprën penale të ndërhyrjeve të padrejta në jetën private. Sipas vlerësimit, kjo dispozitë krijon mbivendosje me dispozitat e tjera Kodit Penal dhe nuk është në harmoni me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale.

Nga shqyrtimi i praktikës shoqëruese të projektligjit, relacionit shoqërues apo raportit të komisioneve përgjegjëse, vihet re nuk përcaktohet asnjë arsye e mbështetur në të dhëna konkrete, e cila të ketë diktuar nevojën e amendimit të kësaj dispozite të Kodit Penal.

Paragrafi i katërt i nenit 121 të Kodit Penal, sipas ndryshimeve të miratuara me ligjin nr.44/2019, kërkon patjetër përmirësim, sepse ka shumë paqartësi në lidhje me subjektin e

veprës penale. Për më tepër, duke analizuar këtë përmbajtje të nenit me nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale, sepse neni 121 i Kodit Penal, siç është aktualisht, hyn në grupin e atyre veprave penale, që ndiqen nga vetë viktimat akuzuese e dëmtuar nga kryerja e veprës penale drejtpërdrejt në gjykatë, nevojitet edhe ndryshimi i nenit 59 i Kodit të Procedurës Penale për të saktësuar nëse dhe për cilin prej këtyre paragrafëve ndjekja penale do të ushtrohet nga vetë viktimat akuzuese apo nga prokurori.

Neni 6 i ligjit, i cili ndryshon nenin 201 të Kodit Penal, paragrafët 2 dhe 5, përmbajnë shprehje abstrakte, përdorimi i të cilave jo vetëm e bën të pamundur zbatimin këtyre paragrafëve në praktikë, por krijon rrezik që të sjellë një precedent në ushtrimin e ndjekjes penale apo dhënien e dënimeve në mënyrë jo proporcionale.

Përmirësimi i nenit 201, që ka të bëjë me veprat në fushën mjedisit, është tejet i mirëpritur nga të gjithë. Ndërkohë kjo dispozitë, e riformuluar në 4 paragrafët e tjerë, paraqet problematikë për sa i përket mënyrës se si ajo është ndërtuar me shprehje të papërshtatshme, të cilat parashikojnë rrethana të cilësuarat të kryerjes së veprës penale.

Rrethanat e cilësuarat konsiderohen elemente të vetë veprimtarisë kriminale dhe, për pasojë, duhet të verifikohen në mënyrë të pakundërshtueshme përtej çdo dyshimi gjatë procesit të hetimit dhe gjykimit penal, për të bërë të mundur kërkimin apo aplikimin e një mase dënimi më të ashpër ndaj subjektit që i ka kryer ato.

Në këto kushte, kur në 4 paragrafët e nenit të ndryshuar përdoret togfjalëshi “ose ka mundësi të shkaktojë”, pra lihet mundësisht shkaktimi i një pasoje të caktuar, kjo normë krijon paqartësi dhe hapësirë për abuzim në praktikë nga organet ligjzbatuese, si: prokuroria, OPGJ-ja apo edhe nga vetë gjykata në dhënien e vendimeve.

Neni 11 i ligjit është një tjetër nen i konstatuar nga ne se ka problematikë. Aty parashikohet shtimi i nenit 207/a dhe sanksionohet si vepër penale braktisja e kafshës së shoqërimit. Nuk rezulton të jetë përcaktuar subjekti i veprës penale dhe formulimi i saj paraqet paqartësi që vështirësojnë aplikimin e saj në praktikë.

Kjo dispozitë, përveç të tjerave, ka paqartësi dhe është formuluar jo mirë për sa i takon edhe teknikës legislative, pasi para së gjithash nuk përcakton saktë subjektin e veprës penale.

Presidenti i Republikës ka vlerësuar se një pjesë e dispozitave të mësipërme nuk mund të jenë plotësisht efikase si një burim për të luftuar sjelljet e padëshirueshme shoqërore, që mund të lindin sipas veprave penale të propozuara për t’u ndryshuar, pasi nisur nga mënyra se si një pjesë e këtyre dispozitave janë miratuar, është e pashmangshme që ato do të

hasin pengesa në praktikë, pikërisht për shkak të paqartësisë apo dykuptimësisë së tyre në disa paragrafë.

Për këto arsye, Presidenti, për dekretin me të njëjtin objekt shqyrtimi, ka vendosur kthimin për rishqyrtim të këtij ligji, me qëllim rishikimin e vetëm të këtyre katër dispozitave, me qëllim qartësimin dhe përmirësimin e tyre në këtë drejtim.

Për sa u takon dispozitave të tjera, Presidenti është shprehur dakord në relacionin dhe në arsyet bashkëlidhur dekretit.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Dervishaj!

Zonja Ministre, fjala është për ju, për të na folur në lidhje me arsyet që jep Presidenti për kthimin e këtij ligji për rishqyrtim në Kuvend. Duam një rivlerësim të Ministrisë së Drejtësisë dhe më pas të relatores.

Etila Gjoni – I nderuar, zoti kryetar,

Të nderuar anëtarë,

Së pari, ju falënderoj për ftesën për të diskutuar këtë nismë shumë të rëndësishme!

Së dyti, ju uroj një sesion të mbarë dhe një bashkëpunim të frytshëm, duke qenë se Ministria e Drejtësisë dhe qeveria shqiptare kanë sjellë pranë Kuvendit disa nisma ligjore shumë të rëndësishme, që plotësojnë ndryshimet e Kodit Penal në luftën kundër kriminalitetit.

Ndryshimet e propozuara në Kodin Penal, në projektligj të kthyer për rishikim nga Presidenti, kanë pasur si qëllim kryesor luftën pa kompromis ndaj kriminalitetit. Duke pasur në konsideratë që ka pasur një mungesë të instrumenteve apo dënimeve të paplota për të luftuar disa forma të reja të krimit, u mendua të hartoheshin këto dispozita dhe ndryshime në Kodin Penal.

Pa dyshim, këto problematika dhe ndryshime kanë ardhur edhe si rezultat i mungesës së efektshmërisë në luftën kundër kriminalitetit, por ky projektligj, i cili është miratuar nga Kuvendi, ka një rëndësi të veçantë, sepse është e vërtetë që ashpërsimi i politikës penale nuk është e vetmja rrugë për të luftuar kriminalitetin, por në situatën në të cilën ndodhemi, dhe të diktuar, gjithashtu, nga nevoja e mbrojtjes së disa të drejtave të qytetarëve apo të funksionarëve publikë, solli pikërisht këto ndryshime. Kjo duhet mbajtur në konsideratë dhe jam e bindur që edhe institucioni i Presidentit i ka mbajtur, pavarësisht kërkesës për ta kthyer për rishqyrtim këtë projektligj.

Gjithashtu, rëndësia e ndryshimeve në Kodin Penal ka të bëjë edhe me një sërë fenomenesh, siç thashë, pra me forma të reja të krimit. Po të shikojmë disa nga momentet,

format apo marshet e dënimit që parashikohen në ndryshimet e Kodit Penal, kanë të bëjnë me një sërë rastesh të prekjës dhe të cenimit të autoritetit të shtetit. Këtu kemi në konsideratë protestat e dhunshme, të zhvilluara para disa muajve, të cilat tejkaluan çdo limit të prekjës së autoritetit të shtetit, duke prekur, duke cenuar figurën e Policisë së Shtetit dhe atyre që mbrojnë dhe garantojnë sigurinë e institucioneve publike.

Ndër veprat penale që, gjithashtu, kanë pësuar ndryshim, janë mbrojtja e mjedisit dhe siguria ushqimore, si një nga fenomenet më të rëndësishme për të mbrojtur jetën dhe të drejtat e qytetarëve. Të gjitha parashikimet ligjore në Kodin Penal, pra këto ndryshime kanë si qëllim të sigurojnë dhe të garantojnë sigurinë ushqimore për të mbrojtur qytetarët.

Një formë dhe një ndryshim tjetër, që është bërë në Kodin Penal, është neglizhenca në trajtimin mjekësor apo mbrojtja e të drejtave të kafshëve, si një propozim i 37 mijë qytetarëve.

I përmenda të gjitha këto, sepse, është e vërtetë, siç e kam shprehur edhe unë, që Kodi Penal, kërkon një analizë të thelluar për t'u ndryshuar, por ka ardhur koha për ta rishikuar dhe për të pasur një Kod të ri Penal. Kjo nuk do të thotë se nga diktimi i këtyre nevojave emergjente për të zgjidhur situata, të cilat janë kthyer në një problem shqetësues si për qytetarët, edhe për funksionarët publikë apo institucionet shtetërore, të mos bëhen ndryshimet, që janë shumë të rëndësishme. Këtë praktikë nuk e kemi ndjekur vetëm ne, por edhe vendet, të cilat kanë pasur nevojë të parashikonin forma të reja të krimit, duke parashikuar edhe ndryshime të shpeshta të Kodit Penal.

Unë nuk e shikoj si argument faktin, që meqenëse nuk kemi Gjykatë Kushtetuese, apo mungesë të funksionimit me efektshmëri të Gjykatës së Lartë, këto të bëhen shkak për të mos pasur ndryshime në legjislacion. Përkundrazi, ne të gjithë duhet të sensibilizohemi për të qenë shumë të kujdesshëm dhe për t'i parë të gjitha këto ndryshime me grupe pune të përbashkëta. Siç jeni në dijeni, ekspertë të Kuvendit kanë punuar me ekspertë të Ministrisë së Drejtësisë apo të disa ministrive të tjera, ku fushat e përgjegjësisë së tyre kanë qenë të lidhura dhe të përfshira në ndryshimet e Kodit Penal. Kjo ka bërë që ky diskutim dhe këto ndryshime t'i nënshtrohen marrjes së mendimeve të grupeve të interesave, duke e përmbyllur të gjithë ciklin dhe për t'u treguar sa më të kujdesshëm me të gjitha ndryshimet që u janë bërë dispozitave të Kodit Penal.

E dyta, do të theksoja se e drejta e Presidentit, pa dyshim, për ta kthyer ligjin për rishqyrtim, është një e drejtë kushtetuese, por, sido që të jetë, ushtrimi i kësaj të drejte duhet bërë me kujdesin e duhur, që, nga njëra anë, të mos cenojë funksionin legjislativ, që

Kushtetuta ia njej Kuvendit, por, nga ana tjetër, të mos cenojë, pa shkaqe të ligjshme apo të arsyeshme, marrëdhëniet juridike të posaçme, që nevojiten të rregullohen nëpërmjet ligjit.

Do të përmendja edhe dy-tri raste apo shqetësime, që këshilltari i Presidentit ngriti në komision, që kanë të bëjnë me formulimin e paqartësisë së disa normave, me qëllim apo me pasojë, që mund të sjellin për aplikime të ndryshme të gjitha normat dhe dispozitat e parashikuara në Kodin Penal.

Së pari, janë parë me shumë vëmendje direktivat e Bashkimi European dhe disa prej tyre, sidomos veprat penale, që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, kanë të bëjnë me transpozimin e dispozitave dhe direktivave të Bashkimit European.

Nga ana tjetër, të gjitha normat dhe dispozitat janë parë me grupe të përbashkëta ekspertësh dhe nuk mund t'i konsiderojmë që lënë vend për paqartësi apo për mungesë zbatueshmërie të njëjtë nga ligjzbatuesit si prokuroria, oficerët e Policisë Gjyqësore apo edhe vetë gjykatat.

Për sa i përket shqetësimit që ngriti këshilltari i Presidentit për nenin 121, është e vërtetë që Presidenti ka vendosur të ushtrojë të drejtën e kthimit për rishqyrtim të këtij ligji, për shkak se paragrafi i katërt i nenit 121, që rregullon ndërhyrjet e padrejta në jetën private nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, që, sipas tij, mund të krijojë paqartësi për subjektin e veprës penale dhe mund të mbivendoset me nenin 122, që rregullon përhapjen e sekreteve vetjake, apo çështja që rregullohet nga dispozita e përgjithshme e Kodit Penal, që lidhet me shpërdorimin e detyrës, neni 248 të Kodit Penal, ekspertët kanë çmuar që ka një dallim të qartë ndërmjet nevojës për të mbrojtur ndërhyrjet në jetën private, kur ajo kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror apo shërbimi publik, nga personi që disponon këto të dhëna për shkak të detyrës shtetërore apo shërbimi publik, si dhe përhapjes së sekreteve vetjake si dy vepra penale të ndryshme dhe që nuk krijojnë mbivendosje.

Për sa i përket arsyetimit të kthimit të dekretit të Presidentit, si shkaqe për kthimin e projektligjit, duke përmendur shprehjet abstrakte nga paragrafi i dytë deri në paragrafin e pestë të nenit 201 të Kodit Penal, si shprehje abstrakte apo të papërshtatshme Presidenti ka konsideruar togfjalëshin “ose ka mundësi të shkaktojë”, e përdorur në cilësimin e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga kryerja e veprave penale në fushën e mjedisit.

Të gjitha ndryshimet që lidhen me veprat penale në fushën e mjedisit janë, në fakt, ashtu siç përmenda, transpozimi i plotë i direktivës së Bashkimit European për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal. Marrëdhëniet që mbrohen, si dhe gjuha e përdorur në këto

dispozita është e njëjtë me marrëdhëniet që mbrohen dhe gjuhën e përdorur në këtë direktivë të Bashkimit Europian, e cila, nëse do të kishte ndodhur ndryshe, nuk do të kishim arritur dot të bënim transpozimin e plotë të direktivës.

Qëllimi pse është përdorur kjo terminologji është shpjeguar në pikën 5 të preambulës të direktivës përkatëse të Bashkimit Europian dhe është pikërisht për mbrojtjen më efektive të mjedisit.

Së fundi, në arsyet e kthimit të ligjit, që shoqërojnë dekretin e Presidentit, ku ka arsyetuar se vepra penale që lidhet me braktisjen e kafshës së shoqërimit që nuk ka subjekt, pra, nuk është përcaktuar se kush ka detyrimin për të mos braktisur ose vendosur maskën mbrojtëse të kafshës së shoqërimit, të gjitha këto aspekte të tjera ligjore janë të rregulluara në ligjin për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë. Kodi Penal, me parashikimet që përmban, padyshim lidhet me elementet dhe kriteret që përmban edhe ligji që rregullon në mënyrë specifike këtë detyrim apo procedurë.

Prandaj, me të gjitha arsyet që përmendi këshilltari i Presidentit dhe ato çfarë kemi lexuar në argumentimet e kthyer nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, mendoj që dekreti i Presidentit duhet të rrëzohet.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Ministre!

Fjalën e ka relatorja, zonja Xhina. Më pas do të vazhdojmë me pyetje dhe përgjigje nga kolegët.

Elena Xhina - Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj zotin Dervishaj për parashtrimin e argumenteve për dekretin e Presidentit! Nga ana tjetër, falënderoj ministren për kornizën ligjore që na solli për mbështetjen e ndryshimeve ligjore nr. 44 të vitit 2019! Në vijim të tyre, dua të argumentoj.

Për sa u përket pretendimeve të ngritura në dekret, fillimisht për nenin 3, të ligjit nr. 44/2019, ku argumentohet për nenin 121 të Kodit Penal, i cili ndryshon nëpërmjet kësaj pakete ligjore, dispozitë e cila është analizuar në veçanti dhe i është kushtuar më tepër vëmendje nga Presidenti, paragrafi i katërt i saj, e cila ka përcaktuar rrethanat cilësuese të kryerjes së veprës, posaçërisht subjektin e veprës penale, pra, funksionarin shtetëror apo shërbimin publik, që për shkak të këtij funksioni ose nëpërmjet shfrytëzimit të këtij funksioni mund të konsumojë elementë të veprës së re penale të parashikuar, dhe sipas analizës në dekret ky paragraf mund të sjellë mbivendosje me vepra të tjera penale (Presidenti i referohet nenit 122 të Kodit Penal, që është ekzistues në Kodin Penal), dua të sqaroj se ligjvënësi, në

ndryshimin që i ka bërë kësaj dispozite, ka vlerësuar si parësore dhe të rëndësishme mbrojtjen efektive të jetës private, si dhe parandalimin e fenomenit të shantazhit ndaj individëve për qëllime të ndryshme.

Për sa i përket faktit pse ka ardhur ky ndryshim, mjafton të shikojmë në media se çfarë ka ndodhur kohët e fundit me fenomenet e përhapjes së sekreteve apo të jetës private të individëve të ndryshëm dhe do të ishte më se e nevojshme që ne të vazhdonim t'u referoheshim ndryshimeve të sjella, si nga grupi i deputetëve, gjithashtu edhe nga qeveria për nenin 121 të Kodit Penal.

Duke u nisur nga këto raste, të cilat janë bërë shpesh publike në media, mbi abuzimin që është bërë në publikimin e të dhënave private, që kanë prekur në veçanti gra dhe të mitur, nga deputetët ka ardhur propozimi për rishikimin e nenin 121.

Për sa i përket argumentit të paraqitur se duhet një dallim edhe më i fortë në subjektin e veprës penale, sipas parashikimeve të paragrafit katër, të sapomiraturar, dhe atë të nenit pasardhës, nenit 122, i cili nënkupton një kategori funksionarësh shtetërorë apo publikë, që për shkak të detyrës, disponojnë këto të dhëna, tërheq vëmendjen se nëse do të lexohen me kujdes të dy nenet, është qartësisht e dukshme se në secilin nen kemi të bëjmë me figura të ndryshme penale.

Nëse do të analizonim elementet përbërëse të figurave të veprave penale, të parashikuara nga të dy nenet, do të kuptonim qartësisht se parashikimet ligjore janë krejtësisht të ndryshme nga njëra-tjetra.

Në nenin 121, subjekti i posaçëm është personi që ushtron funksione shtetërore ose publike ose personi që disponon të dhëna për shkak të funksionit apo shërbimit publik, i cili, nëpërmjet shfrytëzimit të këtyre funksioneve konsumon një nga format e kryerjes së veprës penale, siç mund të jetë vendosja e aparaturave që shërbejnë për dëgjim ose regjistrim të fjalëve apo figurave, dëgjimin ose regjistrimin e fjalëve, publikimin e të dhënave e të tjera, jo si pjesë e detyrave funksionale të tij, por me iniciativën e tij, duke shfrytëzuar mundësinë që në këtë rast jep pozicioni i tij. Në nenin 122 të Kodit Penal aktual bëhet fjalë për ato të dhëna që funksionari publik i siguron gjatë ushtrimit të detyrës së tij, për të cilat ka detyrim t'i ruajë, por që me qëllim përfitimi apo për të dëmtuar dikë tjetër i keqpërdor.

Nga ana tjetër, në këto parashikime, ajo që bën dallimin kryesor është ana objektive. Në nenin 121, ana objektive e figurës së veprës penale përbëhet nga vendosja e aparaturave, që shërbejnë për regjistrimin, dëgjimin dhe fiksimin e aspekteve të ndryshme të jetës private,

ruajtjen apo publikimin e këtyre të dhënave, si dhe shpërndarja në çdo formë e të dhënave të përfituara në këtë formë të paligjshme.

Ndërsa, në nenin 122 të Kodit Penal në fuqi, ana objektive përbëhet nga përhapja e një sekreti të jetës private. Pra, një aspekt krejt tjetër dhe i ndryshëm nga vendosja e aparaturave për regjistrim, pa dijeninë e personit të dëmtuar. Subjekti i veprës penale, të parashikuar në nenin 122, i ka përftuar sekretet vetjake në mënyrë të ligjshme, me vullnetin e lirë të personit që tashmë mund të rezultojë i dëmtuar nga vepra penale dhe në asnjë rrethanë dhe kurrësi nuk mund të konfondohej me subjektin e posaçëm të parashikuar në paragrafin e katërt të nenit 121.

I njëjti qëndrim vlen edhe për argumentin e paraqitur në dekret, se disponimet e nenit 248 të Kodit Penal, që parashikon shpërdorimin e detyrës shtetërore nëpërmjet shkeljes së ligjit dhe me pasoja të rënda ligjore për shtetin dhe shtetasit, janë të mjaftueshme për të trajtuar këto raste. Edhe në nenin 248 të Kodit Penal parashikohen rastet e mospërmbyshjes së rregullt të detyrës nga personi që ushtron funksione publike, por, në dallim nga neni 121, i ndryshuar, sipas të cilit funksionari e kryen veprën penale kur është duke vepruar jashtë detyrës dhe funksioneve që njeh ligji, neni 248 i Kodit Penal kërkon si elemente të figurës së veprës penale përfitimet materiale ose jomateriale të padrejta, duke shpërdoruar detyrën që lidhet drejtpërdrejtë me subjektin e veprës penale, fakt, që neni 121 nuk e kërkon.

Nga ana tjetër, vepra penale e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal ka si objekt të saj mbrojtjen e veprimtarisë shtetërore të kryer nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik, ndërsa vepra penale e parashikuar nga neni 121 ka si objekt të saj mbrojtjen e marrëdhënieve juridike, që sigurojnë paprekshmërinë e moralit dhe dinjitetin e personit.

Nëse do të ndiqnim këtë arsyetim, mund të themi se neni 248 ishte i mjaftueshëm për këtë vepër penale, atëherë edhe neni ekzistues 122 në Kodin Penal, për rrjedhojë, nuk do të duhej të ishte, sepse e mbulonte neni 248. Ndërkohë, praktika ka treguar se të dyja këto dispozita kanë gjetur vendin e tyre në kuadrin ligjor, në praktikën gjyqësore dhe atë penale.

Për sa më sipër, figura e veprës penale, e parashikuar nga neni 121 i Kodit Penal, nuk konkurren me figurën e krimit të shpërdorimit të detyrës, e parashikuar nga neni 248 i tij.

Gjithashtu, në përgjigje të rezervave që shpreh Presidenti në dekretin e tij për konkurrimin e dispozitave, në mungesë edhe të interpretimit nga Gjykata e Lartë, theksojmë se kjo e fundit, tashmë, ka jurisprudencë të konsoliduar në vite për unifikimin e praktikës gjyqësore për çështjet penale.

Për sa i takon shqetësimit të ngritur se paragrafi i katërt i dispozitës së nenit 121, i cili përcakton subjektin e posaçëm, duhet të ripozicionohet si vepër penale, ku janë renditur veprat penale të kryera nga subjektet e posaçme (punonjës shtetërorë), që, megjithëse nuk u përmend këtu, ishte pjesë e dekretit, dua të rikujtoj se në nenin 121, i cili kërkohet të ndryshohet, objekt i figurës së veprës penale është mbrojtja e jetës private të personit dhe fakti që parashikohet një subjekt i posaçëm nuk e largon vëmendjen nga qëllimi i dispozitës, përkundrazi, i siguron një mbrojtje më efektive jetës private. Dua të sjell si shembull paragrafin e pestë të nenit 128/b të Kodit Penal ekzistues, i cili parashikon si subjekt të posaçëm në trupën e dispozitës dhe si objekt të tij ka mbrojtjen e fëmijëve, familjes dhe martesës. Pra, nuk është ndonjë kre më vete.

Së fundi, në dekret ngrihet shqetësimi se paragrafi i katërt i nenit 121 është i paqartë, pasi nuk përcaktohet qartë se për cilin nga veprimet mban përgjegjësi subjekti i posaçëm: për ato të parashikuara në paragrafin e parë apo të dytë të dispozitës.

Lidhur me këtë shqetësim, sqaroj se vepra penale e parashikuar nga neni 121 nga ana objektive parashikon disa forma të kryerjes së saj për të garantuar një mbrojtje më të plotë të jetës private. Mënyra e kryerjes së veprës penale është çmuar të cilësohet nga ligjvënësi, duke i ndarë veprimet e kryera në dy paragrafë, sipas rrezikshmërisë së tyre. Në këto kushte, të dy paragrafët, si ai i pari, ashtu edhe ai i dyti, qoftë veç e veç, qoftë së bashku përbëjnë të njëjtën vepër penale. Si rrjedhojë, formulimi i paragrafit të katërt i nenit 121, i cili fillon: “Kur vepra kryhet nëpërmjet” dhe vazhdon me format pastaj, nuk lë asnjë vend për keqkuptim, pasi është e qartë se bëhet fjalë për veprën penale të parashikuar nga neni 121. Më pas, i mbetet detyrë organit të hetimit të përcaktojë anën objektive të kryerjes së veprës. Ndërsa në lidhje me sugjerimin që pas ndryshimit të nenit 121 është i nevojshëm të bëhet edhe një ndryshim në nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale vlerësoj se një ndryshim i tillë nuk është i nevojshëm. Pavarësisht rritjes së rrezikshmërisë dhe ashpërsimit të sanksioneve në nenin 121 të Kodit Penal, për shkak të natyrës së shkeljes dhe sensibilitetit që ajo paraqet, është vetë personi i dëmtuar që mund të vendosë nëse do t’i drejtohet ose jo gjykatës. Gjithashtu, edhe masa e dënimit nuk është përcaktuese në këto raste. Sjell këtu si shembull nenin 254 të Kodit Penal, i cili ndiqet me ankimin e vetë të dëmtuarit, që ka si masë dënimi deri në pesë vjet burgim.

Lidhur me përmbajtjen e nenit 6 të ligjit nr. 44/2019, Presidenti është shprehur në dekret se ky nen, i cili ndryshon nenin 210 të Kodit Penal, në paragrafët 2 dhe 5 përmban shprehje abstrakte, përdorimi i të cilave jo vetëm e bën të pamundur zbatimin e këtyre paragrafëve në praktikë, por krijon edhe rreziqe dhe sjell një precedent në ushtrimin e

ndjekjes penale apo në dhënien e dënimeve në mënyrë joproporcionale. Sipas dekretit, lënia e hapësirave abstraguese në dispozitë dhe formulimi jo i saktë për sa i takon teknikës legislative është një mundësi e hapur për keqinterpretim dhe abuzim në praktikë. Atëherë, neni 6 i ligjit, që ndryshon nenin 201 të Kodit Penal, përcakton ndotjen e ajrit, të ujit dhe të tokës, si vepra penale me rrezikshmëri të lartë dhe për të cilat ashpërsohen sanksionet. Ndryshimet në nenin 201 të Kodit Penal, si dhe shtesat e disa neneve të reja në këtë kod kanë si qëllim mbrojtjen e mjedisit nga veprimet e kryera nga personat fizikë ose juridikë, me dashje ose nga pakujdesia, të cilat bien ndesh me legjislacionin specifik për mjedisin dhe që rrezikojnë të shkaktojnë një dëm real ndaj cilësisë së ajrit, të ujit, të tokës, të bimëve, të kafshëve, të shëndetit ose të jetës së njeriut. Këto nene janë propozuar dhe janë miratuar në përputhje me kërkesat e direktivës, siç e përmendi zonja ministre më parë, si dhe terminologjia e përdorur në këto nene ka respektuar terminologjinë teknike të direktivës, por duke ruajtur edhe përputhshmërinë me Kodin tonë Penal.

Për sa i përket rezervës që shpreh Presidenti në dekretin e tij, se rrethana e cilësuar e kryerjes së veprës penale, që sjell si rezultat rritjen e masës së dënimit, rezulton të jetë përcaktuar me shprehje të papërshtatshme, vlerësoj se elementi i lidhjes shkakësore të veprës penale, të parashikuar në nenin 6 të ligjit, që ndryshon nenin 201, duke përdorur togfjalëshin “ka mundësi të shkaktojë” është në të njëjtën linjë me elementin e lidhjes shkakësore të parashikuar në nenin 3 të direktivës, sipas së cilës vepra penale kryhet jo vetëm kur ka shkakuar dëme, por edhe kur mund të shkaktojë dëme. Gjithashtu, formulimi në këtë nen është parashikuar, duke parë edhe elementin e lidhjes shkakësore në përputhje me nenin 13 të Kodit Penal “Lidhja shkakësore”, e cila parashikon: “Askush nuk ka përgjegjësi penale kur ndërmjet veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojave, apo mundësisë së ardhjes së tyre, mungon lidhja shkakësore”. Pra, në nenin 13 parashikohet mundësia e ardhjes së pasojave.

Së fundi, lidhur me elementin e lidhjes shkakësore të veprave penale, ky formulim është përdorur edhe më pas në nenin 230 ekzistues të Kodit Penal, ku dispozita përmban titullin “Vepra me qëllime terroriste” dhe në këtë dispozitë është përdorur i njëjti togfjalësh “kanë ardhur pasojat” ose “është krijuar mundësia e ardhjes së pasojave”. Në atë kohë ky formulim është gjetur i ligjshëm dhe në praktikë nuk ka hasur asnjëlloj problematike deri sot.

Lidhur me nenin 7 të ligjit nr. 44/2019, Presidenti është shprehur në dekret se këtu janë përdorur përsëri disa shprehje të papërshtatshme dhe të paqarta, siç janë shprehjet: “në sasi të papërfillshme” dhe “ndikim të papërfillshëm”. Lidhur me sa është paraqitur në dekret, sqaroj se ashtu si në rastin e nenit 6 të ligjit, edhe neni 7 është propozuar dhe është miratuar

në përputhje me kërkesat e direktivës dhe vetë terminologjia e përdorur në këtë nen ka respektuar terminologjinë e teknikës që ka përdorur edhe direktiva. Nga ana tjetër, nga leximi i dispozitave të neneve 201/b, 202 dhe 202/a, rezulton se dispozitat referojnë në ligjin specifik, i cili qartëson në mënyrë eksplicite se cila është sasi e papërfillshme dhe çfarë është ndikimi i papërfillshëm.

Për sa i përket shqetësimit të ngritur se këto vepra nuk përcaktojnë rrethana të cilësuar, si bashkëpunimi ose përsëritja, sqaroj se këto kërkesa i plotëson më së miri pjesa e përgjithshme e Kodit Penal, konkretisht neni 50, në gjerat “gj” dhe “h”, që paraqesin rastet e bashkëpunimit ose të përsëritjes së veprës penale.

Lidhur me nenin 11 të ligjit, ku përsëri në dekret parashtrohen argumentet se vepra penale e parashikuar (që është një vepër e re e parashikuar) nuk është e qartë dhe mund të sjellë paqartësi dhe mundësinë për të mos u aplikuar qartë në nga gjykata dhe prokuroria, duhet të sqaroj se ligjvënësi në hartimin e kësaj dispozite, që ka të bëjë me braktisjen e kafshës, shoqërimin dhe vendosjen e maskës, ka pasur si qëllim përcaktimin e anës objektive të veprës, si dhe pasojat që vijnë prej saj në mjediset publike apo të hapura për publikun.

Për sa i përket përcaktimit të subjektit të veprës, pasi u ngrit pretendimi se në këtë dispozitë nuk është përcaktuar subjekti, kjo bëhet nga organet ligjzbatuese, sipas rastit dhe bazuar në legjislacionin e posaçëm, i cili përcakton në mënyrë të detajuar subjektet përgjegjëse për mbajtjen e kafshëve. Mospërcaktimi i subjektit të veprës penale vihet re në shumicën e dispozitave të Kodit Penal, por nuk ka dalë asnjëherë si problematikë dhe nuk ka sjellë moszbatim ose paqartësi në zbatimin e dispozitave.

Lidhur me shqetësimin e ngritur, që kjo dispozitë nuk parashikon rastin kur plagosja e rëndë nga kafsha ndodh në banesën e pronarit të kafshës, sqaroj se qëllimi i dispozitës është të rregullojë vetëm rastet e braktisjes së kafshës apo mosvendosjes së masës së shoqërimit, në rastet kur ajo sjell pasoja në shëndetin e njerëzve.

Në përfundim, duke vlerësuar se argumentet e paraqitura në dekretin e Presidentit të Republikës nr.11248, datë 05.08.2019, nuk kanë bazë kushtetuese, si dhe duke vlerësuar se nenet e kontestuara janë hartuar qartë dhe në përputhje e në harmoni me të gjitha dispozitat e tjera të Kodit Penal, ftoj anëtarët e komisionit të votojnë kundër dekretit të Presidentit.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Xhina!

A ka pyetje nga kolegët? Ka zoti Braho pyetje.

Ndizeni mikrofonin.

Spartak Braho –Pa u zgjatur, zoti Bledar, ju mbuloni një pozicion shumë fisnik, shumë dinjitoz dhe, pa dyshim, ju vlerësoj si jurist. Gjatë periudhës që ju keni qenë këshilltar i Presidentit për çështjet juridike, për statistikë, sa dekrete i ka kthyer Kuvendi Presidentit? Mbaji shënim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam edhe pyetje të tjera.

Së dyti, sa nga këto dekretet e kthyer i keni dërguar dhe i keni goditur në Gjykatën Kushtetuese?

Së treti, për dy dekretet e sotme (meqë i kemi edhe të freskëta), sa probleme të shkeljeve kushtetuese, që kanë ligjet e propozuara, keni ngritur ju? Se të merresh me shprehje abstrakte e të tjerë nuk është në dinjitetin e dekreteve që kthen Presidenti. Megjithatë, unë do ta bëj këtë analizë mbas përgjigjes së pyetjeve tuaja.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Braho!

Po, zoti Dervishaj.

Bledar Dervishaj- Në dy vjet veprimtari të Presidentit të Republikës janë trajtuar 193 ligje (të më saktësojë drejtoresha juridike, nëse janë 193 apo 197). Nga këto janë kthyer për rishqyrtim 19 ligje në dy vjet. Ka pasur 19 dekrete të kthimit të ligjeve për rishqyrtim. Në muajin korrik ne kemi bërë një statistikë të veprimtarisë kushtetuese dhe e kemi bërë me dije këtë.

Sa janë goditur në Gjykatën Kushtetuese? Është goditur dhe është depozituar vetëm padia për ligjin për Teatrin Kombëtar, për të dyja normat, edhe të parin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta mbaroj arsyetimin.

Po vlerësohet mundësia e depozitimit të secilit prej këtyre ligjeve, pasi jemi ende në aftin që përcakton ligji për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese.

Sa probleme kushtetuese janë ngritur? Në vlerësimin e Presidentit të Republikës, por edhe timin, si këshilltar i tij ligjor...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nejse, m'u drejtua edhe mua, si këshilltar ligjor.

Kthimi i ligjeve nuk bëhet vetëm për arsye kushtetuese. Presidenti është pjesë e procesit parlamentar në fund të tij dhe rekomandimet pozitive për përmirësimin e normës duhet të pranohen nga Kuvendi. Të vogla apo të mëdha, ato janë defekte.

Ne e kemi thënë, Kodi Penal cenon parimin e sigurisë juridike, sepse vetë Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka thënë: “Mungesa e qartësisë së normës, aplikimi i gabuar në praktikë, cenimi i sigurisë juridike”. A është ky një parim kushtetues? Po, është.

Kështu që, kryesisht, ne i kemi kthyer ligjet për antikushtetutshmëri, cenim të interesit publik, mungesë qartësie...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arsyet e kthimit të ligjeve në Kuvend janë gjithmonë në funksion të interesit publik, të kushtetutshmërisë dhe parimeve themelore kushtetuese. Kështu që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Spartak Braho -...që konstatoni shkelje kushtetuese në ligjet që miraton Kuvendi dhe nuk i drejtoheni Gjykatës Kushtetuese. Vetëm për një ligj, për ligjin për Teatrin.

Prandaj, shikojeni me kujdes këtë, sepse ashtu siç mbajnë përgjegjësi ministria dhe Kuvendi, edhe ju mbani përgjegjësi, sepse konstatoni shkelje të Kushtetutës dhe nuk reagoni.

Jo, nuk ka nevojë për përgjigje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja –Po, zoti Dervishaj, por, ju lutem, përmbajuni objektit të sotëm, shqyrtimit të dekretit!

Bledar Dervishaj – Asgjë nuk është e rëndë. Po të kishim një Gjykatë Kushtetuese funksionale, ju siguroj që do të ishin depozituar të gjitha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Bledar Dervishaj – Do të jetë, por, kur të bëhet funksionale, ju siguroj se..

Shumica e këtyre ligjeve i përkasin këtij sesioni, pra nga janari e këtej...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Braho, ta përfundojë mendimin zoti Dervishi! E thashë që në fillim, ju lutem, fokusohuni te shqyrtimi i dekretit që kemi sot...!

Bledar Dervishaj – Po e përmbledh: Presidenti i ka mirëpritur ndryshimet në Kodin Penal. E ka rikthyer këtë ligj për rishqyrtim, në vlerësimin dhe në kompetencën e tij kushtetuese, për përmirësimin e 4 normave, të 4 dispozitave.

A po ushtron një kompetencë kushtetuese? Patjetër që po.

A është në të drejtën e tij? Po, është. Kjo nuk duhet të vihet në diskutim.

Debati është profesional, për qartësimin e disa normave, rregullimin dhe përmirësimin e tyre.

Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese, që ne e kemi cituar në arsyetim, nuk janë funksionale dhe kujdesi i Kuvendit duhet të jetë maksimal në hartimin e dispozitës penale, sepse ka të bëjë drejtpërdrejt me ndëshkimin e individit. Kjo është arsyeja e vetme.

Nga relatorja u përmend fakti që ka edhe raste të tjera kur paqartësi të normave (ka mundësi të shkaktojë) ka edhe në disa dispozita të tjera. Kur diçka nuk është bërë tërësisht mirë herët e tjera, nuk do të thotë të vazhdojmë me të njëjtën linjë.

Për këto arsye dhe për sa është trajtuar në mënyrë shumë shteruese në dekret, kërkojmë nga komisioni që dekreti të pranohet dhe dispozitat që ne kemi menduar se kanë problematikë dhe i kemi vlerësuar, të përmirësohen.

E përmbyll këtu fjalën time.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Dervishaj!

A ka pyetje të tjera? A ka diskutime?

Ka një pyetje zonja Hysi dhe më pas ka diskutime.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Dervishaj!

Në relacionin që shoqëron dekretin e Presidentit, është sugjeruar të ndryshojë neni 59 i Kodit të Procedurës Penale, pra për viktimën akuzuese, me argumentin që ky ndryshim diktohet nga nevoja e rritjes së masës së dënimit që ka bërë për ligjvënësin në nenin 121.

Në vlerësimin tuaj, neni 59 i Kodit të Procedurës Penale, është nisur nga rrezikshmëria shoqërore e veprës penale, apo është nisur nga fakti që kemi të bëjmë me të dhëna personale sensitive dhe është subjekti, pra viktimja, ajo që duhet ta vlerësojë nëse duhet të ketë një procedim të tillë për të kërkuar dëmshpërblimin apo dhe për t'u thirrur në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën e bërë?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Dervishaj.

Bledar Dervishaj – Përgjigjja është sipas vlerësimit që ka bërë Presidenti i Republikës. Këtu kemi një dispozitë me një paragraf, neni 121 i Kodit Penal, dhe po ndryshon e po bëhet me 4 paragrafë. Në krahasim me dispozitën 59 të Kodit të Procedurës Penale ne kemi pyetur mos është me vend që të ndryshohet edhe ajo, sepse kjo, siç është aktualisht, hyn në llojin e atyre veprave që ndiqet nga viktimja akuzuese. Meqë po forcojmë ndëshkimin penal, a mos është vendi që edhe në Kodin e Procedurës Penale të ndryshojë se

cili nga këta paragrafë do të ndiqet nga viktimat akuzuese dhe cila nga organet ligjzbatuese? Ky ka qenë qëllimi i arsyetimit për të cilin kemi folur qartë.

Ulsi Manja – Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Shumë faleminderit për sqarimin! Mënyra se si ju i dhatë përgjigje pyetjes bën sens, por mënyra si është paraqitur shqetësimi i ngritur në relacionin që shoqëron dekretin e Presidentit, nuk është kjo që sapo thatë. Më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj që në faqen 3 të relacionit, i cili shoqëron dekretin e Presidentit, ju thoni që neni 3 i ligjit nr. 44/2019 nuk është në harmoni me parashikimet e KPP-së çka na detyron ne si ligjvënës të shohim nëse është në harmoni apo jo. Çështja që ju ngritët nuk ka të bëjë me harmoninë, por me një vlerësim apo gjykim tuajin që për shkak se në ndryshimin që i është bërë nenit 121 ka edhe elemente të tjera të veprës penale, ose subjekte të tjera që mbrohen në mënyrë të posaçme, duhej ndryshuar Kodi i Procedurës Penale, pra janë dy gjëra shumë të ndryshme. Në vlerësimin tim neni 59 i Kodit të Procedurës Penale i jep përparësi të drejtës që ka viktimat akuzuese të vendosë vetë, nëse dëshiron të paraqitet në gjykatë duke marrë pjesë si palë dhe të kërkojë dëmshpërblimin ose jo, sepse kemi të bëjmë me disa të dhëna dhe me jetën e saj private. E dyta, ka ndryshim shumë të madh me atë konkluzion që keni arritur ju në relacionin që shoqëron dekretin e Presidentit.

Në fjalën tuaj, dhe do të më falni, zoti kryetar, ju thatë që neni 121 ka qenë një paragraf dhe është bërë me 4 paragrafë. Besoj se nuk ka asgjë kushtetuese që një nen i Kodit të Procedurës Penale apo i çdo kodi tjetër, të plotësohet, të rishihet dhe të zhvillohet në përputhje me zhvillimet që ka nxjerrë praktika.

Më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj që mbrojtja e personave të mitur është një problem i diskutuar gjerësisht dhe ky propozim ka ardhur nga të gjitha organizatat vendase dhe ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, sepse ju keni parë shpesh që edhe në rrjetet sociale janë postuar video, janë hedhur regjistrime, të cilat kanë dëmtuar rëndë jetën dhe shëndetin e të miturve, madje kanë çuar edhe në akte të vetëflijimit të të miturve. Pikërisht në këtë kuadër besoj se është shumë gjë e mirë që kjo mbrojtje e posaçme, që i jepet personit të mitur, është parashikuar në nenin 121.

A duhet që tashmë ta lëmë në varësi të dëshirës së të miturit dhe të kujdestarit të tij për të kërkuar të marrë pjesë në proces apo të kërkojë dëmshpërblim? Kjo është një çështje tjetër që mund të diskutohet, por kurrësi nuk e bën këtë ligj të paqartë e as nuk është në mungesë të harmonisë. Në fund të fundit është vullneti i ligjvënësit deri në çfarë niveli do të kërkojë mbrojtjen e viktimave akuzuese.

Gjithashtu, në relacion më bëri përshtypje fakti që te neni 121, paragrafi 1 është hequr fjala “transmetim” dhe ky paragraf i kësaj dispozite nuk ka ndryshim. Në vlerësimin tuaj heqja e fjalës “transmetimi i figurave” të rezultuara nga vendosja e aparaturave të përgjimit dhe shtimi i paragrafit të posaçëm “shpërndarja, ofrimi për publikim, publikimi me çdo mjet ose një formë të komunikimit publik” janë dy gjëra të ndryshme? Ku qëndron pakushtetutshmëria e riformulimit që u është bërë neneve 1 dhe 2 të nenit 212?

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Zoti Dervishaj, do t’ju lutesha në mënyrë të përmbledhur!

Bledar Dervishaj - Faleminderit profesoreshë!

Pyetja që m’u drejtua është pak intriguese, për arsye se ne nuk kemi thënë që heqja e fjalës “transmetim” përbën antikushtetutshmëri. Ne kemi bërë konstatim të faktit që paragrafi i parë është i njëjtë pa fjalën “transmetim” dhe është transpozuar më mbrapa. Nuk kemi thënë këtë prandaj çfarë përgjigje të jap?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, se e ka kërkuar fjalën zoti Braho!

Diskutimi lidhur me ndryshimet në Kodin Penal ka qenë shterues edhe në komision, edhe në seancë plenare. Sot po shqyrtojmë dekretin e Presidentit. A ka arsye kushtetuese dhe ligjore të përligjura në argumentet që jep Presidenti që e përfshijnë Komisionin e Ligjeve për ta parë me një sy tjetër këtë dekret apo nuk ka? Leksione këtu të së drejtës penale nëse fjala “transmetim” është te paragrafi i parë dhe a është zbërthyer te paragrafi i dytë, kush është jurist e di që është zbërthyer në mënyrë shteruese se çfarë do të thotë “transmetim”. Atje ishte “transmetim dhe në praktikë lindte nevoja të sqarohej se çfarë nënkupton transmetimi dhe poshtë e keni shteruar duke thënë: shpërndarja, ofrimi për publikim, publikimi etj. Të gjitha janë forma transmetimi. Gjithsesi, të mos fokusohemi te debati teknik, por të mbahemi te dekreti.

Po, fjala për ju, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Për të mbyllur, zoti kryetar.

Paragrafi 2 i neni 121 që kanë sjellë propozuesit dhe që e tha me të drejtë relatorja, është po ai paragraf që ka ekzistuar në paragrafin 1 të Kodit Penal, sepse nga paragrafi 1 i Kodit Penal nuk është hequr vetëm fjala “transmetim i figurave”, por edhe publikimi i këtyre të dhënave që ekspozojnë një aspekt të jetës private dhe kanë kaluar si paragrafë të dytë. Pikërisht në relacionin që shoqëron dekretin e Presidentit është goditur paragrafi i dytë, duke thënë që është në përplasje me nenet e tjera. Ka qenë aty të neni 121, sepse nga neni 121

propozuesit kanë hequr transmetimin e figurës dhe publikimin e të gjitha të dhënave që ekspozojnë jetën private të personit. Me këtë argument unë solla diçka për saktësi dhe transparencë, sepse krijohet përshtypja sikur në nenin 121 ne kemi bërë shumë ndryshime, të cilat krijojnë përplasje me dispozitat e tjera të Kodit Penal.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit, zonja Hysi!

A ka pyetje të tjera?

Zoti Braho ka diskutim.

Spartak Braho- I nderuar, zoti Dervishi,

Po ia hiqni tullat Presidentit. Nga 130 dekrete, 21 dekrete bashkë me këto dyja sot i kthehen mbrapsht. Unë nuk dua të merrem me përmbajtjen, sepse relatoi shumë mirë relatorja dhe zonja ministre. Neve na mbetet të flasim vetëm për teknikën legjislative që ngrini ju si problematikë apo për abstraksionet e tjera, gjë që nuk është dinjitoze që në dekretet e Presidentit të kërkohet të rregullohet teknika legjislative. Thelbi dhe serioziteti i dekreteve të Presidentit janë problemet kushtetuese. Natyrisht që rishikimi përfshin një gamë të gjerë të problematikës, unë këtë e di shumë mirë dhe e vlerësoj, por ju në asnjë rast, unë nuk e mbaj mend, në 19 apo 21 dekrete që keni, nuk keni ngritur probleme të mirëfillta kushtetuese dhe Komisioni i Ligjeve apo parlamenti të mos reagojë. Prandaj, dua t'ju them që të jeni më dinjitozë në kundërshtimin e ligjeve që Presidenti kërkon për t'i zhdekretuar nëpërmjet dekreteve.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Braho!

Zoti Dervishaj, jemi në fazën e diskutimeve dhe në fund do të shpreheni për qëndrimin që ka presidenti për dekretin, ministria dhe komisioni.

Zoti Përmeti e ka kërkuar fjalën për diskutim.

Andi Përmeti – Unë besoj se ne kemi bërë ndryshime pozitive në Kodin Penal. Është bërë një punë e madhe për një kod që është teknik dhe nuk ka lidhje me politikën. Janë bërë ndryshime teknike, të cilat sjellin një mbrojtje më të madhe për qytetarët shqiptarë. Unë vetë kam bërë disa propozime konkrete, qoftë me relatoren, zonjën Xhina, qoftë me zonjën Hysi, të cilat janë marrë parasysh, duke sjellë një përmirësim të Kodit Penal, i cili ka pasur shumë probleme, por për të qenë i sinqertë dhe në rregull edhe me ndërgjegjen time, po të rikthehesha pas do të kërkoja dhe do të propozoja një tjetër ndryshim në Kod, për të cilin dua t'u kërkoj ndjesë qytetarëve që nuk e kam propozuar, që do të ishte shpërdorimi për luks i parave publike nga personat publikë, të cilët zgjedhin të harxhojnë 700 euro për të fjetur një

natë nga taksat e qytetarëve të një nga shteteve më të varfra të Europës për luksin e tyre. Unë e kisha këtë brejtje ndërgjegjeje dhe për këtë arsye do ta propozoja këtë ndryshim, zonja Xhina.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Zoti Permeti, faleminderit!

Zoti Permeti, ne e kemi të plotë kuadrin ligjor penal, gjithsesi ky ishte sugjerimi juaj.

A ka diskutime të tjera nga kolegët?

Po, zonja Mara.

Aurora Mara- Faleminderit, kryetar!

Falënderoj relatoren për qartësimin, faleminderit Elena, si dhe grupin e punës për gatishmërinë, përkushtimin dhe përgjegjshmërinë.

Ndryshimet në Kodin Penal kanë qenë të domosdoshme. Është punuar me shumë përkushtim si nga ana jonë, ashtu edhe nga maxhoranca dhe nga të gjithë përfaqësuesit e Kuvendit në Komisionin e Ligjeve.

Zoti kryetar, dua të ndalem te neni 121 dhe të jap një shpjegim të shkurtër, në të cilin bëhet fjalë për ndërhyrje të padrejta në jetën private. Pas ndryshimeve të bëra nga ne, ky nen është ndarë në 4 kategori të veprës penale; në pjesën e parë është vendosja e aparaturave që shërbejnë për dëgjim apo regjistrim të fjalëve apo figurave, dëgjimi ose regjistrimi i fjalëve, fiksimi ose regjistrimi i figurave, si dhe ruajtja për publikim pa pëlqimin e personit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose burgim deri në dy vjet. Në këtë pjesë është futur vetëm vendosja, regjistrimi, dëgjimi, regjistrimi i fjalëve apo figurave, fiksimi dhe ruajtja për publikim pa pëlqimin, që përbën kundërvajtje dhe burgim deri në dy vjet.

Në pjesën e dytë kemi ndarë aspektin e shpërndarjes: “Shpërndarja, ofrimi për publikim apo publikimi dënohet me burgim deri në tri vjet.”. Kjo ndarje është bërë për faktin se nuk mund të dënohet një person që vendos një aparaturë, e regjistron, e fikson figurën, e ruan për publikim, si ai person që e shpërndan, e ofron për publikim diskutimin ose figurën. Domethënë, ndarja është bërë, sepse janë dy vepra penale të ndryshme: vendosja, regjistrimi dhe fiksimi janë ndryshe nga shpërndarja dhe nga ofrimi për publikim.

Në pjesën e tretë, po kjo vepër penale, kur kryhet ndaj personave të mitur dënohet me burgim nga 1 deri në 3 vjet. Në këtë moment është mbrojtja ndaj të miturit, që zonja Hysi e parashikoi dhe e shpjegoi shumë mirë, ku ne jemi të detyruar të marrim masa më të rënda në këto lloj rrethanash.

Në pjesën e katërt janë rastet kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, apo nga personi që disponon këto të dhëna për shkak të detyrës shtetërore apo shërbimit publik, që dënohet me burgim nga 1 deri në 3 vjet. Në këtë rast e kemi rënduar dënimin ndaj personave, të cilët kanë detyrë shtetërore apo shërbejnë në shërbimin publik, sepse në këtë moment, përveç dëmit si privat ky person dhunon edhe sekretin profesional.

Ne kemi punuar me këtë lloj filozofie pune, jemi angazhuar, jemi përkushtuar dhe besojmë se puna është bërë e rregullt dhe e qartë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Mara!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Dervishi, mos e konsumoni paraprakisht fjalën, sepse duhet të shpreheni në fund për dekretin.

Para se ta hedhim në votim, edhe unë kam një konsideratë për dekretin dhe për arsyet e kthimit që jep Presidenti. Në fakt, diskutimi dhe arsyeja që jep Presidenti, unë bashkohem me Kolegun tim Braho, por edhe me disa kolegë të tjerë që janë tërësisht çështje të teknikës legislative, por, janë të qarta nisur nga mënyra se si janë hartuar dhe janë shkruar në tekstin e Kodit Penal që ne miratuar. Në lidhje me nenin 121, që u referohet ndërhyrjeve të padrejta në jetën private, ky jo vetëm që ka qenë një propozim i ardhur nga Këshilli i Ministrave, por është një nen që është diskutuar gjatë në grupin e punës. Kanë qenë disa sugjerime me vlerë të dy kolegeve tona të nderuara: Eglantina Gjermani dhe Evis Kushi, të cilat kanë sjellë propozime konkrete dhe propozime që janë marrë nga kodet penale bashkohore sot në Europë, sepse është e qartë për të gjithë që jeta private, përveç të tjerave, kërkon edhe një forcim të mbrojtjes me masa penale. Gjithsesi, është shumë e qartë dispozita, neni 121 është shumë i qartë, dhe nuk ka konfundim jo vetëm brenda përbrenda paragrafëve të këtij neni, por as me nenin 122. Pra, flitet për dy gjëra krejtësisht të ndryshme.

Presidenti ka shqetësimin se, nëse do të pranohet ndryshimet e nenit 121 në paragrafin 4 në lidhje me subjektin e posaçëm, duhet të ndryshohet neni 59 i Kodit të Procedurës Penale. Jo Kodi Penal në strukturën e veprave penale ka shumë vepra penale, që janë krime dhe është lënë në subjektin dhe çmimin e viktimës nëse do t'i drejtohet gjykatës ose jo.

Dua të sjell vëmendjen e kolegëve juristë: kryerja e marrëdhënieve seksuale me të rritura është krim, sipas Kodit Penal, por, në fakt, është në rrethin e veprave penale që ndiqen

sipas nenit 59. Është në çmimin e viktimës nëse cenimin e aspekteve të jetës private, do ta denoncojë pranë organeve kompetente ose jo. Pra, nuk ka probleme të përplasjes ligjore midis Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës në lidhje me nenin 121. Ajo që dua të them është se qëllimi i ligjvënësit është pozitiv.

Në lidhje me arsyet e tjera që paraqet Presidenti, për ndryshimet në paketën e Kodit Penal për sa u përket krimeve mjedisore dhe në fushën e mbrojtjes së kafshëve, ato janë as më shumë dhe as më pak transpozimi i një direktive të Bashkimit European, që ne e kemi pasur si detyrim për ta transponuar shumë kohë më parë, por rasti e solli që kjo direktivë e Bashkimit European për mbrojtjen e mjedisit dhe kafshëve, nëpërmjet masave penale, të bëhet në këtë kohë, meqëqëse kishte edhe një paketë propozimesh për ndryshime në Kodin Penal nga Këshilli i Ministrave për sa i përket rendit dhe sigurisë publike, mbrojtjes së posaçme të bluzave të bardha, punonjësve të Policisë së Shtetit, si dhe një kategori ndryshimesh, që janë përfshirë në Kodin Penal. Duke mos parë arsye thelbësore të natyrës kushtetuese dhe ligjore, por thjesht çështje të teknikës legjislative, që ashtu siç e thashë pak më parë, kanë qenë shqetësim për Presidentin, por, në fakt, në vlerësimin e komisionit, por edhe të Kuvendit janë qartësisht të ditura. Gjithsesi, ne duhet t'u hapim rrugë këtyre ndryshime në Kodin Penal që të hyjnë në fuqi. Ligjet nuk janë tabu, por do të jenë punonjësit e praktikës, pra gjyqtarët dhe prokurorët, oficerët e Policisë Gjyqësore, që në veprimtarinë e tyre të përditshme, në qoftë se do të ketë probleme të paqartësisë së normës apo dispozitave të caktuara ligjore, qoftë në Kodin Penal, qoftë në Kodin e Procedurës Penale, Kuvendi në çdo rast do t'u përgjigjet nevojave të punonjësve të praktikës.

Kështu që unë bashkohem me mendimin e relatores, të kolegëve të mi të komisionit, por edhe të ministres së Drejtësisë, zonjës Gjonaj, që, natyrisht, u shpreh për rrëzimin e dekretit të Presidentit të Republikës. Bazuar në Rregulloren e Kuvendit, nuk na mbetet gjë tjetër veçse ta hedh në votim dekretin e Presidentit të Republikës, por para se ta hedh në votim, ministrja e Drejtësisë kërkon të shprehet për të.

Etilda Gjonaj - Zoti kryetar, edhe pasi dëgjova këshilltarin e Presidentit, ne qartësisht i mbetemi faktit që ky dekret duhet rrëzuar. Kodi Penal ka nevojë për ndryshime të tjera dhe ne jemi të vetëdijshëm që duhet të rishikohet, ashtu siç thashë që të kemi një Kod të ri Penal. Ministria e Drejtësisë së bashku me një grup ekspertësh kanë filluar analizën për të parë të gjithë problematikën dhe për të sjellë një propozim për një Kod të ri Penal. Gjithashtu, ftoj këdo, pa dyshim që anëtarët e Komisionit të Ligjeve do të jenë pjesë e kësaj nisme; ftoj edhe zotin Përmeti që, në qoftë se ka sugjerime konkrete për çështje, të cilat e shqetësojnë

atë, atëherë është i ftuar në këtë grup pune, pavarësisht se ky kuadër ligjor është tashmë i plotësuar.

Dua të them se zoti Përmeti nuk duhet të bjerë pre e atyre që deformojnë informacionin dhe të vërtetën dhe ushqejnë sulme mbi bazën e disa lajmeve të pavërteta.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Ministre!

Zoti Dervishaj, ju i qëndroni asaj që keni dhënë.

Ju lutem, vetëm për pranimin e dekretit. Ju jeni për pranimin e dekretit?

Bledar Dervishaj – Ne jemi për pranimin e dekretit nga ky komision dhe më pas nga seanca plenare.

Ulsi Manja – Faleminderit!

E hedhim në votim dekretin e Presidentit të Republikës për kthim dhe rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 44/2019 “Për disa shtesa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Kush është dakord për rrëzimin e dekretit të Presidentit? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Rrëzohet dekreti i Presidentit të Republikës me nr. 11 248, datë 05.08.2019. Për të dyja këto dekrete relatorët të bëjnë gati raportin për t’i kaluar në seancën plenare të radhës.

Faleminderit, zonja Ministre për prezencën sot në komision bashkë me stafin tuaj!

Faleminderit, zoti Dervishaj dhe zonja Fanaj, për prezencën tuaj!

Këtu e mbyllim mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Rendi i ditës do t’ju njoftohet nga sekretaria e komisionit.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA